

Seances Plenare  
10/01/2023



**KUVENDI I SHQIPËRISË**  
*Deputet*

**KUVENDI**  
NR 55 DATE 09.01.23

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më 09/01/2023

**Lënda:** Propozim për shqyrtim dhe miratim projektligj

**Drejtuar:** Zonjës Lindita Nikolla  
Kryetare e Kuvendit të Shqipërisë

**E nderuar Zonja Kryetare,**

Bazuar në nenin 81, pika 1, të Kushtetutës të Republikën së Shqipërisë dhe nenit 68, pika 1, të Rregullores së Kuvendit të Republikën së Shqipërisë, Ju paraqesim për shqyrtim dhe miratim në Kuvend projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin, nr.53/2019, datë 18.07.2019 “Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë””, me propozimin e **një grupi deputetësh.**

**Bashkëlidhur:**

**Projektligji:** “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin, nr.53/2019, datë 18.07.2019 “Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë””

**Relacioni:** Shpjegues i Projektligjit.

**Me respekt,**

*Ismael Beqiraj*

*Relno Koci*



# REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KUVENDI

### PROJEKTLIGJ

Nr. \_\_\_/2023

#### PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 53/2019, DATË 18.07.2019 “PËR AKADEMINË E SHKENCAVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

Në mbështetje të neneve 78, 81, pika 1, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh.

### KUVENDI

#### I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

### VENDOSI:

Në Ligjin, nr.53/2019, datë 18.07.2019 “Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë”, bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

#### Neni 1

*Në nenin 6, pika 3, të ligjit, hiqen fjalët “i anëtarëve të jashtëm deri në 10 dhe i anëtarëve korrespondente deri në 15”, si dhe hiqen fjalët “Këta të fundit nuk përfshihen në llogaritjen e kufirit maksimal të sipërcituar”, pika 3, riformulohet me këtë përmbajtje:*

*“3. Asambleja zgjedh edhe anëtarë të jashtëm ndër personat me shtetësi apo origjinë shqiptare me banim jashtë vendit, figura të shkencës e të kulturës, si dhe anëtarë nderi ndër figurat e shkencës e të kulturës që janë shtetas joshqiptarë me banim jashtë vendit, të cilët me punimet e tyre kanë ndikuar në ecurinë e mendimit e të zbatimit të shkencës në Shqipëri apo në promovimin e të vërtetave dhe të vlerave të origjinës, gjuhës e kulturës shqiptare.*

*Numri i anëtarëve të nderit është deri në 15. Personat me origjinë shqiptare që janë anëtarë me të drejta të plota të një akademie pjesëtare të “All European Academies”, fitojnë drejtpërdrejt statusin e anëtarit të jashtëm të Akademisë së Shkencave, e cila formalizohet nga një mbledhje ceremoniale e Asamblesë.”*

## Neni 2

*Neni 10, riformulohet me këtë përmbajtje:*

*“Anëtarët e jashtëm dhe ata të nderit kanë të drejtë të marrin pjesë në mbledhjet e Asamblesë, pa të drejtë vote, si dhe në të gjithë aktivitetet e Akademisë. Me pëlqimin e tyre, ata aktivizohen dhe kontribuojnë në plotësimin e detyrave të Akademisë dhe të anëtarëve të saj, të parashikuara në nenet 4 dhe 9 të këtij ligji.*”

## Neni 3

*Në neni 11, që lidhet me organet ekzekutive të Akademisë, pika 3, riformulohet si vijon: “3. Kryetari i Akademisë së Shkencave dhe anëtarët e Kryesisë zgjidhen nga Asambleja me votim të fshehtë dhe të drejtëpërdrejtë, me shumicën absolute të votave të vlefshme të anëtarëve të Asamblesë.”*

*Po në nenin 11, pika 4, riformulohet si bashkim i pikës 8 dhe 9 duke shtuar në fillim të fjalisë së parë, togfjalshin “Kryetari dhe”, si dhe hiqet nga fjalia e dytë, togfjalshi “por jo radhazi”, si vijon:*

*“4. Mandati i Kryetarit dhe zëvendëskryetarit është 4 vjet, ndërsa ai sekretarit shkencor dhe drejtuesve të seksioneve është 5 vjet.*

*Kryetari, zëvendëskryetari, sekretari shkencor dhe drejtuesit e seksioneve mund të rizgjidhen në të njëjtin funksion për dy mandate.”*

*Pika 11, e këtij neni bëhet 9.*

## Neni 4

*Në nenin 14, pika 4, hiqet fjala “korrespondent”, dhe zvendësohet me fjalën “i jashtëm”.*

## Neni 5

*Në nenin 16, që lidhet me “ndërprerjen e mandateve”, hiqet gërma “c” e pikës 2, ndërsa pika “ç” bëhet “c”.*

## Neni 6

*Në nenin 22, që lidhet me “Dispozitat e fundit” për “Administratën”, shtohet pika 6, me këtë përmbajtje:*

*“6. Pagat e anëtarëve të Kryesisë janë sipas tabelës bashkëngjitur këtij projektligji, ndërsa për punonjësit dhe drejtuesit shkencorë joadministrativ, si dhe të atyre të njësive të kërkim-studimit përcaktohen sipas nenit 19, pika 3 dhe 4, të këtij ligji.”*

## Neni 7

### Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**K R Y E T A R I**

**Lindita NIKOLLA**

Miratuar në datën .....